ANSIG
INSURANCE COMPANY

siguro qetësinë tënde

- Sigurimi i mjeteve motorike
- Sigurimi i pasurisë
- Sigurimi i shëndetit dhe aksidenteve në udhetim
- Sigurimi i garancisë
- Sigurimi projekteve inxhinierike
- Sigurimi i mjeteve monetare
- Sigurimi i përgjegjësive
- Sigurimi për mjetet lundruese fluturuese

INDIVID **BIZNES**

3 Raporti i Audituesit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

6 • Pasqyra e Pozicionit Financiar

7 • Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Përmbledhëse

8 • Paqyra e Ndryshimeve në Kapital

9 • Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

10 • Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare

11 • Skedulet Suplementare

Deloitte Albania sh.p.k
Rr. Elbasanit.
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-Miniera
Tirana, Albania

Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.al

Place of registration: Tirana Court, Decision 16016
VAT (NUIS) No:J62329003N

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtimit dhe aksionarëve të ANSIG sh.a:

Raport mbi Pasqyrat Financiare Individuale

1. Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të ANSIG sh.a ("Shoqëria"), bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën individuale të ndryshimit të kapitalit dhe pasqyrën individuale të rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, si dhe një përmbledhje të parimeve bazë kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare individuale

2. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale pa pasaktësi materiale si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Audituesit

3. Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare individuale. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

4. Auditimi përfshin kryerjen e proçedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit, për vlerat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshi këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së gabimeve në pasqyrat financiare, qofshin këto si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

5. Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit të kualifikuar të auditimit.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Bazat për opinion të kualifikuar

6. Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale bashkëngjitur, Shoqëria ka vlerësuar dëmet e ndodhura por jo të raportuara ("IBNR") duke aplikuar një normë mbi dëmet e raportuara por të papaguara ("RBNS"), të llogaritur në bazë të të dhënave historike. Duke përdorur këtë metodologji, Shoqëria ka regjistruar IBNR në shumën prej 3,866 mijë Lek.
Metodologjia e përdorur nga drejtimi për vlerësimin e IBNR nuk është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare aktuariale, sepse ajo është e bazuar në një analizën e një raporti të thjeshtë. Gjithashtu, dëmet që janë në çështje gjyqësore më 31 dhjetor 2013, janë përjashtuar nga baza e llogaritjes së rezervës për IBNR, praktikë e cila nuk është e përshtatshme krahasuar me praktikat më të mira ndërkombëtare aktuariale. Duke përdorur praktikat më të mira aktuariale ndërkombëtare dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga Shoqëria, ne vlerësuam se rezerva e krijuar për IBNR më 31 dhjetor 2013 është materialisht e nënvlerësuar. Megjithatë, duke marrë në konsideratë mangësitë në vlerësimin e Drejtimit mbi zhvillimin e dëmeve dhe raportin e dëmeve neto, si pasojë kryesisht e historikut të shkurtër të zhvillimit të dëmeve të Shoqërisë, ne nuk jemi në gjendje të arrijmë në një përfundim me saktësi dhe siguri të plotë mbi shumën e rregullimeve të mëtejshme të nevojshme për rezervën e IBNR më 31 dhjetor 2013. Shënimet e pasqyrave financiare nuk japin informacion shpjegues të mjaftueshëm për këto çështje, ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare individuale dhe rreziqet e pasojave të tjera që mund të rezultojnë.

7. Rezerva Teknike e Primit të Pafituar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013 ishte 232,305 mijë Lek. Testi i mjaftueshmërisë së rezervës mbi primin e pafituar në fund të vitit tregon pamjaftueshmëri në rezerva, e cila nuk është regjistruar në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013. Sipas SNRF 4 "Kontratat e sigurimit", në qoftë se identifikohet një pamjaftueshmëri ajo duhet të përfshihet menjëherë në fitim ose humbje, duke krijuar një provigjion mbi rrezikun e paskaduar nga humbjet që lindin nga testi i mjaftueshmërisë së rezervave. Si pasojë, ne nuk ishim në gjëndje të merrnim siguri mbi plotësinë dhe vlerësimin e Rezervës mbi Primin e Pafituar dhe Ndryshimit në Rezervën e Primit të Pafituar më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013.

Opinion i Kualifikuar

8. Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafet 6 deri në 7 të Bazat për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare individuale paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të ANSIG sh.a më 31 dhjetor 2013, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

9. Pasqyrat financiare individuale të ANSIG sh.a më 31 dhjetor 2012 dhe për periudhën nga 19 janar 2012 deri në 31 dhjetor 2012, janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar mbi këto pasqyra më 21 gusht 2013, në lidhje me kapitalizimin e papërshtatshëm të shpenzimeve në aktive të tjera dhe me shtyrjen e papërshtatshme të kostove të marrjes në sigurim.

Raport mbi kërkesa të tjera ligjore dhe rregullatore – kërkesa të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë për Aftësinë Paguese dhe Aktivet në Mbulim të Rezervave Teknike.

10. Në vijim të kërkesave të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare të Republikës së Shqipërisë, ne kemi lexuar Skedulet Suplementare të Marzhit të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave teknike bashkëngjitur, të cilat nuk janë pjesë e pasqyrave financiare individuale bashkëngjitur. Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e Skeduleve Suplementare mbi Marzhin e Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave teknike, në përputhje me ligjin "Për Veprimtarinë e Sigurimit, të Risigurimit dhe Ndërmjetësimit në Sigurime dhe Risigurime" nr. 9267, datë 29 korrik 2004.

    Përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafet 6 deri në 7 në Bazat për Opinion të Kualifikuar, informacioni financiar i paraqitur në Skedulet Suplementare të Marzhit të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim të Rezervave teknike të përgatitura nga Drejtimi është në përputhje me informacionin financiar vjetor, të paraqitur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2013.

    Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 96, datë 3 shkurt 2008 dhe në ndryshimet e bëra në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 7 janar 2009, shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të mbajnë aktive në mbulim të provigjioneve teknike dhe matematike, jo më pak se vlera bruto e provigjioneve teknike. Siç është llogaritur në Skedulin 2, në Skedulin Suplementar të Aktiveve në Mbulim të Rezervave teknike, aktivet në mbulim të rezervave teknike dhe matematike më 31 dhjetor 2013 ishin 67% e rezervave teknike bruto. Për rrjedhojë, vlera e pambuluar e rezervës teknike në atë datë ishte 87,076 mijë Lek.

Deloitte Albania sh.p.k

31 korrik 2014
Tiranë, Shqipëri

Deloitte Albania
Rr.Elbasanit, Pll.P... KATI I-TË GJEOLOGJI MINIERA
Tirana - Albania
Tel: +355 4 45 17 999 Fax: ... 45 17 999
NIPT: ... J32326...N

Elvis Ziu
Partner Angazhimi

PASQYRAT FINANCIARE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përvecse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2013	Më 31 dhjetor 2012
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	5	7,318,770	9,483,215
Depozita bankare me afat	6	402,781,784	400,708,582
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	7	84,230,165	48,187,808
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	8	112,055,796	48,034,028
Aktive të lidhura me risigurimin	9	10,187,972	7,708,835
Aktive të tjera	10	17,626,184	18,181,812
Tatim fitimi i arkëtueshëm		268,328	-
Aktive afatgjata jo materiale, neto	11	2,560,047	2,242,491
Aktive afatgjata materiale, neto	12	181,815,521	41,655,069
TOTALI I AKTIVEVE		**818,844,567**	**576,201,840**
DETYRIME			
Rezervat teknike	13	264,216,596	113,007,773
Të pagueshme nga aktiviteti i risigurimit	14	11,051,166	7,323,423
Detyrime të tjera	15	228,531,267	46,782,044
Qira financiare të pagueshme	16	22,875,856	15,034,148
Të ardhura të përfituara në avancë		683,243	-
TOTALI I DETYRIMEVE		**527,358,128**	**182,147,388**
KAPITALI AKSIONAR			
Kapitali aksionar	17	394,000,000	394,000,000
Rezerva ligjore		18,151	-
Fitimi i pashpërndarë		36,301	-
(Humbja) / Fitimi i vitit		(102,568,013)	54,452
TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR		**291,486,439**	**394,054,452**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT AKSIONAR		**818,844,567**	**576,201,840**

Pasqyrat financiare u autorizuan nga Drejtuesit e Shoqërisë më 30 Maj 2014 dhe u nënshkrua në emër të tij nga:

Fatbardha Zhubjaku
Zëvendës Drejtoreshë e Përgjithshme

Donika Kapollari
Shefe e Financës

Shënimet shpjeguese në faqet 8 deri në 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

PASQYRAT FITIM - HUMBJE

dhe te ardhurave te tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përvecse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për periudhën nga 19 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012
Prime të shkruara bruto	18	394,465,043	179,538,126
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar	13	(119,569,863)	(112,735,610)
Të ardhurat bruto nga primet e sigurimit		**274,895,180**	**66,802,516**
Prime të ceduara në risigurim	19	(19,430,166)	(13,292,816)
Ndryshime në rezervën e primit të pafituar, pjesa e risiguruesit		2,479,137	7,708,835
Primet e fituara neto		**257,944,151**	**61,218,535**
Të ardhura të tjera		181,717	212,241
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		760,987	152,905
Të ardhura neto		**258,886,855**	**61,583,681**
Dëme të ndodhura të sigurimit dhe shpenzime për trajtim dëmi, neto	20	**(79,229,997)**	**(3,733,966)**
Kostot e marrjes në sigurim	21	(156,283,747)	(26,659,089)
Shpenzime administrative	22	(114,821,011)	(35,900,777)
Shpenzime të tjera sigurimi		(22,091,393)	(6,203,852)
Shpenzime të tjera		(1,446,741)	-
Humbje operative		**(114,986,034)**	**(10,914,003)**
Të ardhura nga interesi	24	17,927,071	13,798,149
Shpenzime interesi		(2,155,583)	(68,340)
Humbje nga kursi i këmbimit	23	(3,353,467)	(2,056,976)
Të ardhura financiare, neto		**12,418,021**	**11,672,834**
(Humbja) / Fitimi i vitit para tatimit		**(102,568,013)**	**758,831**
Tatim fitimi	25	-	704,379
(Humbja) / Fitimi pas tatimit		**(102,568,013)**	**54,452**
Të ardhura të tjera përmbledhëse		-	-
Totali i të ardhura përmbledhëse për vitin		**(102,568,013)**	**54,452**

PASQYRAT E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përvecse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Fitimi / (humbja) e mbartur	Totali
Gjendja më 19 janar 2012	-	-	-	-
Kapital i paguar	394,000,000	-	-	394,000,000
Rezerva ligjore	-	-	-	-
Fitimi i periudhës dhe të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	54,452	54,452
Gjendja më 31 dhjetor 2012	394,000,000	-	54,452	394,054,452
Rezerva ligjore	-	18,151	(18,151)	-
Rritje në kapitalin aksionar	-	-	-	-
Humbja e vitit dhe të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	(102,568,013)	(102,568,013)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	394,000,000	18,151	(102,531,712)	291,486,439

PASQYRAT E RRJEDHES SE PARASE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përvecse kur përcaktohet ndryshe)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013	Për periudhën nga 19 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ		
(Humbja) / Fitimi neto para tatimit	**(102,568,013)**	**758,831**
Rregullime për të rakorduar rrjedhën e parasë neto nga aktiviteti operativ:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,932,860	2,811,058
Rënia në vlerë	-	-
Të ardhura nga interesi	(17,927,071)	(13,798,149)
Efekte të kursit të këmbimit	(24,006)	-
Rrjedha e parasë nga aktiviteti operativ para lëvizjeve në kapitalin punues	**(106,586,230)**	**(10,228,260)**
Ndryshime në:		
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	(47,776,520)	(48,187,808)
Aktive të tjera	712,760	(18,181,812)
Aktive të lidhura me risigurimin	(2,479,137)	(7,708,835)
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	(64,021,767)	(48,034,028)
Rezervat teknike	151,208,823	113,007,773
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i risigurimit	3,727,743	7,323,423
Detyrime të lidhura me sigurimin dhe të tjera	201,582,876	46,782,044
Tatim fitimi i paguar	(268,328)	(704,379)
Interesi i arkëtuar	20,402,417	7,977,967
Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga aktiviteti operativ	**156,502,637**	**52,274,345**
Rrjedha e parasë nga aktivitet investues		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(153,159,774)	(29,120,047)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(958,760)	(2,554,396)
Rritja në depozitat me afat	(4,548,548)	(394,888,400)
Rrjedha neto e parasë e përdorur gjatë aktivitetit investues	**(158,667,082)**	**(426,562,870)**
Rrjedha e parasë nga aktiviteti financues		
Kapital i paguar	-	394,000,000
Rrjedha neto e parasë e gjeneruar nga aktiviteti financues	-	**394,000,000**
(Rënie) / rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	**(2,164,445)**	**9,483,215**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	**9,483,215**	-
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit (Shënimi 5)	**7,318,770**	**9,483,215**

SHENIME SHPJEGUESE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përvecse kur përcaktohet ndryshe)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

ANSIG sh.a. , referuar si ("Shoqëria"), është një shoqëri aksionare shqiptare me vendodhje në Tiranë, e cila ofron shërbime sigurimi jo-jetë për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, anijet dhe lloje të tjera sigurimesh.

Shoqëria është e regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit më 19 janar 2012, në përputhje me ligjin Shqiptar nr. 8081, datë 7 mars 1996, "Për bizneset siguruese dhe risiguruese" dhe është subjekt i ligjit nr.9267 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" datë 29 korrik 2004 (Ligji i Sigurimit). Zyrat qëndrore te Shoqërise ndodhen në rrugën "Donika Kastrioti", Vila 9/1, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria u licensua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sipas vendimit nr.76, datë 22 qershor 2012.

Shoqëria zotërohet 100% nga aksionari i vetëm Z. Piro Angjeli.

Më 31 dhjetor 2013 Shoqëria zhvillonte aktivitetin me anë të selisë qëndrore në Tiranë dhe kishte degë në Tiranë, Berat, Shkodër, Durrës, Lushnje, Fier, Dibër, Korçë, Vlorë, Elbasan, Lezhë, Gjirokastër etj.

Më 31 dhjetor 2013, shoqëria kishte punësuar gjithsej 110 punonjës (më dhjetor 2012: 90 punonjës).

SKEDULE SUPLEMETNARE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përvecse kur përcaktohet ndryshe)

SKEDULI 1 - MARZHI I AFTËSISË PAGUESE

Marzhi i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2013 është si vijon:

	December 31, 2013
Të ardhura nga primet e sigurimit	394,465,043
Të ardhura nga primet e risigurimit	-
Totali	**394,465,043**
Pjesa e totalit që nuk e kalon vlerën 1,000,000,000 Lek	394,465,043
Pjesa e totalit që e kalon vlerën 1,000,000,000 Lek	-
A1 x 0.18	71,003,708
A2 x 0.16	-
Totali	**71,003,708**
Dëme të paguara bruto	43,325,907
Dëme të paguara nga risiguruesi	-
Dëme të paguara, neto	43,325,907
Rezerva teknike e dëmeve bruto të vitit aktual	31,911,123
Rezerva teknike e dëmeve bruto të vitit paraardhës	272,163
Pjesa e risiguruesit në rezerva teknike të dëmeve të vitit aktual	-
Pjesa e risiguruesit në rezerva teknike të dëmeve të vitit paraardhës	-
Rezerva teknike e dëmeve neto të vitit aktual	31,911,123
Rezerva teknike e dëmeve neto të vitit paraardhes	272,163
Ndryshimi në rezervat teknike bruto	31,638,960
Ndryshimi në rezervat teknike neto	31,638,960
Dëme të ndodhura bruto	**74,964,867**
Dëme të ndodhura neto	**74,964,867**
Raporti i dëmeve	**100%**
Rezultati nga llogaritja në bazë të primeve	**71,003,708**

Elementët e marzhit të aftësisë paguese	**Amounts in Lek**
Kapitali aksionar i paguar	394,000,000
Rezerva të tjera jo të lidhura me rreziqet e nënshkruara	18,151
Humbja e akumuluar	(102,568,012)
Aktive afatgjata jomateriale	(2,560,047)
Totali	**288,890,092**
Marzhi minimal i kërkuar	**71,003,708**
	Ka aftësi paguese

ZYRAT QENDRORE
Rruga Donika Kastrioti - Villa 9/1, Tirane - ALBANIA
Nipt: L21319037M
Phone: +355 42 263 490 Fax: +355 42 263 486
Email: info@ansig.al Web: www.ansig.al

ANSIG
INSURANCE COMPANY

siguro qetësinë tënde